


*“Mjerisht, mes krijimit të parë ... dhe lindjes së re në Krishtin, që i bën besimtarët vëllezër e motra..., ekziston realiteti negativ i mëkatit, që herë pas here e ndërpret vëllazërinë krijuese dhe vazhdimisht deformon bukurinë dhe fisnikërinë e të qenurit vëllezër e motra të së njëjtës familje njerëzore”.*

PAPA FRANCESKU



# Kisha dhe Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 1 JANAR 2017 Çmimi 30 lekë



Nga e gjithë bota  
lartësohet e fortë  
thirrja për Paqe

JO DHUNA:  
STILI NJË POLITIKE PAQEJE

Jo dhuna: Stil i një  
politike paqeje *faqe 3-4*

Domenikanët në  
800-vjetorin e urdhërit  
dhe prania e tyre në Shqipëri *faqe 5*

Lutje e Shën Tomë Akuinit *faqe 5*

Françesku: bashkimi i të  
krishterëve është shpresë për  
Evropën *faqe 6*

Së bashku në të njëjtin Krisht  
e në të njëjtin Ungjill *faqe 6*

Kisha dhe të rinjtë: Paraqitet  
Dokumenti përgatitor i  
Sinodit *faqe 8*

Çka është e drejtë dhe e  
gabuar në fejesë?

*Nga Dom Marjan LUMÇI faqe 9*

Bukuria e shpirtit *faqe 10*

Dele të humbura,  
apo ujë grabitqarë?  
Dëshmitarët e Jehovahit?!!!

*Nga Dom Marjan LUMÇI faqe 10-11*

“Donin ta kapnin, por  
askush nuk guxoi të vinte  
dorë mbi të” *faqe 12*

Adriano Celentano vs  
Dario Fo *faqe 12*

# Kalendari Liturgjik

## Shkurt 2017

Kushtimi i Jezusit  
në Tempull



Kur, sipas Ligjit të Moisiut, u mbushën ditët e pastrimit të tyre, e çuan në Jerusalem, për t'ia kushtuar Zotit, sikurse shkruan në Ligjin e Zotit: *‘Çdo i parëlindur mashkull le t'i kushtohet Zotit’* dhe për të dhënë flinë sikurse thuhet në Ligjin e Zotit; *‘një parë turtuj ose dy zogj pëllumbash.’*

Në Jerusalem aso here jetonte një njeri, që quhej Simon. Ishte njeri i drejtë dhe i përsipirtshëm. Prite Ngushëllimin e Izraelit e në të ishte Shpirti Shenjt. Shpirti Shenjt ia kishte zbuluar se s'do të vdiste pa e parë Mesinë e Zotit. I nxitur prej Shpirtit Shenjt erdhi në Tempull. Kur prindërit e sollën Jezusin Foshnjë për të kryer rregulloren e Ligjit mbi të, Simoni e mori para duarsh,

falënderoi Hyjin e tha:

“Tani, o Zot, mund të lejosh të vdesë shërbëtori yt në paqe sikurse the ti vetë, sepse me sytë e mi e pashë shëlbimin që ti e bërë gati në sy të të gjithë popujve: Dritën që bën të njohin Ty paganët e që i jep nder popullit tënd, Izraelit.”

Prindërit e tij çuditëshin për sa thuhej për të.

Atëherë Simoni i bekoi dhe i tha Marisë, nënës së tij: “Shih! Hyji e caktoi këtë Fëmijë të shkaktojë rrënim e ngritje për shumëkënd në Izrael. Do të jetë edhe shenjë të cilës njerëzit do t'i kundërshtojnë. (edhe ty vetë një shpatë do ta shporojë shpirtin) që të zbulohen shestimet e zemrës së shumëkujt.”

2 shkurt – Kushtimi i Krishtit në Tempull

3 shkurt – Sh. Vlashi

5 shkurt – E DIELA e V GJATË VITIT (A) Sh. Agata

8 shkurt – Sh. Jozefina Bakhita

10 shkurt – Sh. Skolastika

11 shkurt – Zoja e Lurdit

12 shkurt - E DIELA e VI GJATË VITIT (A)

14 shkurt - Sh. Cirili dhe Metodi

19 shkurt – E DIELA e VII GJATË VITIT (A)

22 shkurt – Katedra e shën Pjetrit Apostull

26 shkurt – E DIELA e VIII GJATË VITIT (A)



**Drejtor i përgjithshëm:**

Imzot George Frenco

**Kryeredaktor:**

D. Marjan Lumçi

**Sekretar:**

Ferdinand Ndocaj

**Redaksia:**

Kolec Çefa  
Ana Stakaj  
Zef Skanjeti  
Elidon Dodaj

**Grafika:**

Pjerin Sheldija

**Foto:** Pici

**Adresa:**

Katedralja e Shën Palit,  
Bulevardi Zhan D'Ark,  
Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

# Jo dhuna: Stil i një politike paqeje

Mesazhi i Atit të Shenjtë Papa Françeskut për ditës e 50-të Botërore të Paqes

1 Janar 2017

1. Në fillim të këtij viti të ri u bëj urimet e mia më të sinqerta popujve dhe kombeve të botës, Kryetarëve të Shteteve dhe të Qeverive, si edhe përgjegjësve të bashkësive fetare dhe të grupimeve të ndryshme të shoqërisë civile. I uroj paqen çdo burri, gruaje, djali dhe vajze dhe lutem derisa përngjasimi dhe shëmbëlltyra me Hyjin e çdo personi të na mundësojë që ta njohim njëri-tjetrin si dhurata të shenjta të pajisura me një dinjitet të pafund. Sidomos në situatë konflikti, e respektoshim këtë «dinjitet më të thellë» dhe e bëfshim jodhunën aktive stilin tonë të jetës.

Ky është Mesazhi për Ditën e 50-të Botërore të Paqes. Në të parin, i Lumi Papa Pali VI iu drejtua të gjithë popujve, jo vetëm katolikëve, me fjalë të prera: «Më në fund ka dalë shumë qartë se paqja është linja e vetme dhe e vërtetë e përparimit njerëzor (jo tensionet e nacionalizmave ambiciozë, jo fitoret e dhunshme, jo shtypjet mbartëse të rendeve të rreme civile)». Paralajmëronte «rrezikun për të besuar se kundërshtimet ndërkombëtare nuk mund të zgjidhen me anë të arsyes, domethënë me anë të bisedimeve të bazuara mbi të drejtën, drejtësinë, barazinë, por vetëm me anë të forcave frikësuese dhe vdekjeprurëse». Nga ana tjetër, duke cituar *Pacem in terris* të paraardhësit të vet Shën Gjonit XXIII, lartësonte «domethënie dhe dashurinë për paqen, e cila bazohet mbi të vërtetën, drejtësinë, lirinë, dashurinë». Të prek aktualiteti i këtyre fjalëve, që sot nuk janë më pak të rëndësishme dhe më pak të ngutshme se 50 vjet më përpara.

Me këtë rast dëshiroj të ndalem mbi *jodhunën si stil të një politike paqeje* dhe i kërkoj Hyjit që të na ndihmojë të gjithëve, me qëllim që ta nxjerrim jodhunën prej thellësisë së ndjenjave dhe vlerave tona personale. Dashuria dhe jodhuna e udhëheqë mënyrën me të cilën e trajtojmë njëri-tjetrin në marrëdhëniet ndërpersonale, në ato sociale dhe në ato ndërkombëtare. Kur dinë t'i rezistojnë tundimit të hakmarrjes, viktimat e dhunës mund të jenë protagoniste më të besueshme të proceseve të ndërtimit të paqes. Prej nivelit vendor dhe të përditshëm deri në atë të rendit botëror, jodhuna u bëftë stili karakteristik i vendimeve tona, i marrëdhënieve tona, i veprimeve tona, i politikës në të gjitha format e saj.

## NJË BOTË E COPËTUAR

2. Shekulli i kaluar është shkretuar prej dy Luftrave vdekjeprurëse Botërore, ka njohur kërcënimin e luftës bërthamore dhe një numër të madh konfliktesh të tjera, ndërsa sot për fat të keq jemi në prag të një lufteje të tmerrshme botërore. Nuk është e lehtë të kuptohet nëse bota e sotme është pak a shumë e dhunshme sa ajo e djeshmja, as nëse mjetet moderne të komunikimit dhe lëvizshmëria, që karakterizon epokën tonë, na



bëjnë më të vetëdijshëm për dhunën apo më të mësuar me të. Në çdo rast, kjo dhunë që ushtrohet «pjesë-pjesë», në mënyra dhe nivele të ndryshme, shkakton vuajtje të stërmëdha për të cilat jemi shumë të vetëdijshëm: luftra në Vende dhe kontinente të ndryshme; terrorizëm, kriminalitet dhe sulme të armatosura të paparashikueshme; abuzimet e pësuarra prej emigrantëve dhe viktimave të trafiqeve të paligjshme; shkatërrimi i mjedisit. Me çfarë qëllimi? A e mundëson dhuna arritjen e objektivave në mënyrë afatgjatë? A thua gjithçka që arrin shkakton raprezalje dhe spirale konflikti vdekjeprurës, që u sjellin përfitime vetëm pak «zotërinjve të luftës»?

Dhuna nuk është mjekimi i duhur për botën tonë të thërmuar. T'i përgjigjesh dhunës me dhunë prodhon, në më të mirën e rasteve, një migrim të sforcuar dhe vuajtje çnjerëzore, pasi sasi të mëdha burimesh përdoren për qëllime ushtarake dhe u hiqen nevojave të përditshme të të rinjve, të familjeve në vështirësi, të të moshuarve, të të sëmurëve, të pjesës më të madhe të banorëve të botës. Në rastin më të keq, mund të çojë në vdekje, fizike dhe shpirtërore, të shumë personave, ose madje edhe të të gjithëve.

## LAJMI I MIRË

3. Edhe Jezusi jetoi në kohë dhune. Ai mësoi që fusha e vërtetë e betejës, ku u bëhen ballë dhunës dhe paqes, është zemra njerëzore: «Prej brendisë – prej zemrës së njeriut rrjedhin: mendimet e këqija» (Mk 7,21). Por mesazhi i Krishtit, përpara këtij realiteti, jep përgjigje rrënjësisht pozitive: Ai predikoi pa u lodhur dashurinë e pakushtëzuar të Hyjit, që mikpret e fal, si edhe u mësoi nxënësve të vet që t'i duan armiqtë (krh. Mt 5,44) dhe t'ua kthenin faqen tjetër atyre (krh. Mt 5,39). Kur i pengoi ata që akuzonin gruan kurorëshkelëse, që ta mbysnin atë me gurë (krh. Gjn 8,1-11), dhe kur, natën përpara se të vdiste, i tha Pjetrit që ta fuste shpatën në mill (krh. Mt 26,52), Jezusi

përvijoi udhën e jodhunës, që e përshkoi deri në fund, deri në kryq, nëpërmjet të cilës ka realizuar paqen dhe ka shkatërruar armiqtësinë (krh. Ef 2,14-16). Për këtë arsye, ai që mikpret Lajmin e Mirë të Jezusit, di të dallojë se çfarë sjell dhuna dhe e lë veten të shërohet prej mëshirës së Hyjit, duke u bërë kështu edhe ai vetë vegël e pajtimit, sipas nxitjes së Shën Françeskut të Asizit: «Paqen që kumtoni me gojë, e paçi edhe më të bollshme në zemrat tuaja».

Të jesh nxënës i vërtetë i Jezusit sot do të thotë t'i bashkëngjitesh edhe propozimit të Tij të jodhunës. Ajo – siç ka pohuar paraardhësi im Benedikti XVI – «është realiste, sepse ka parasysh që në botë ka tepër dhunë, tepër padrejtësi, dhe kjo situatë nuk mund të kalohet përveçse duke iu kundërvënë me më shumë dashuri, me më shumë mirësi. Kjo «më shumë» vjen prej Hyjit». Dhe ai shtonte me forcë të madhe: «Jodhuna për të krishterët nuk është thjesht një sjellje taktike, por një mënyrë se si ai është, qëndrimi i atij që është kaq i bindur për dashurinë e Hyjit dhe për fuqinë e Tij, sa që nuk ka frikë t'i bëjë ballë të keqes i pajisur vetëm me armët e dashurisë dhe të së vërtetës. Dashuria për armikun përbën thelbin e «revolucionit të krishterë»». Me të drejtë Ungjilli i *duajini armiqtë tuaj* (krh. Lk 6,27) konsiderohet si «magna charta e jodhunës së krishterë»: ajo nuk ka të bëjë «me dorëzimin përpara të keqes [...], por me faktin që i përgjigjemi të keqes me të mirë (krh. Rom 12,17-21), duke prishur në këtë mënyrë zinxhirin e padrejtësisë».

## MË E FUQISHME SE DHUNA

4. Jodhuna nganjëherë kuptohet si dorëzim, mosangazhim dhe pasivitet, por në realitet nuk është kështu. Kur Nënë Tereza mori çmimin Nobel për Paqen në vitin 1979, shumë qartë e paraqiti mesazhin e saj të jodhunës aktive: «Në familjen tonë nuk kemi nevojë për bomba dhe armë, të shkatërrojme për të sjellë paqen, por

vetëm të qëndrojmë së bashku, për ta dashur njëri-tjetrin [...] dhe kështu mund ta tejkalojmë krejt të keqen që ekziston në botë». Sepse forca e armëve është rrenacake. «Ndërsa trafikantët e armëve bëjnë punën e tyre, janë punëtorët e thjeshtë të paqes që vetëm për të ndihmuar një person, një tjetër, një tjetër, japin jetën e tyre»; për këta punëtorë të paqes, Nënë Tereza është «një simbol, një ikonë e kohëve tona». Në shtator të këtij viti kam pasur gëzimin e madh ta shpall të Shenjtë. Kam lavdëruar gatishmërinë e saj ndaj të gjithëve nëpërmjet «mikpritjes dhe mbrojtjes së jetës njerëzore, asaj ende të palindur dhe asaj të braktisur dhe të skartuar. [...] Është përlulur mbi personat e sflitur, të braktisur buzë rrugës, duke njohur dinjitetin që Hyji u kishte dhënë atyre; ka bërë që të fuqishmit e tokës ta dëgjojnë zërin e saj, që t'i njihnin fajet e tyre përpara krimeve – përpara krimeve! – të varfërisë së krijuar prej vetë atyre». Si përgjigje, misioni i saj – dhe në këtë përfaqëson mijëra, madje miliona njerëz – ka shkuar drejt viktimave me bujari dhe përkushtim, duke prekur dhe duke lidhur çdo trup të plagosur, duke shëruar çdo jetë të copëtuar.

Jodhuna e praktikuar me vendosmëri dhe koherencë ka dhënë rezultate të habitshme. Sukseset e arritura prej Mahatma Gandhi-t dhe Khan Abdul Ghaffar Khan-it për lirim e Indisë, dhe prej Martin Luther King-in kundër diskriminimit racor nuk do të harrohen kurrë. Gratë, në veçanti, shpesh janë lidere të jodhunës, si, p.sh., Leymah Gbowee dhe mijëra gra liberiane, që kanë organizuar takime lutjeje dhe protesta jo të dhunshme (*pray-ins*), duke arritur deri në negociata në nivele të larta për t'i dhënë fund Luftës së Dytë Civile në Liberi [Afrikë].

As nuk mund ta harrojmë dhjetëvjeçarën epokal, që u mbyll me rënien e regjimeve komuniste në Evropë. Bashkësitë e krishtera kanë dhënë kontributin e tyre me lutjen këmbëngulëse dhe veprimin e guximshëm. Ndikim të veçantë kanë ushtruar mbarështimi dhe magjisteri i Shën Gjon Palit II. Duke reflektuar mbi ngjarjet e vitit 1989 në Enciklikën *Centesimus annus* (1991), paraardhësi im thekson që një ndryshim epokal në jetën e popujve, të kombeve dhe të Shteteve realizohet «nëpërmjet një lufte paqësore, që përdor vetëm armët e të vërtetës dhe të drejtësisë». Ky rrugëtim tranzicioni politik drejt paqes është bërë i mundur pjesërisht «prej angazhimit jo të dhunshëm të njerëzve që, ndërsa kurrë nuk kanë pranuar të përdorin pushtetin e forcës, kanë ditur të gjejnë herë pas here forma të efektshme për të dëshmuar të vërtetën». Dhe përfundonte: «Njerëzit mësofshin të luftojnë për drejtësinë pa dhunë, duke hequr dorë prej luftës së klasave në grindjet e brendshme dhe prej luftës në ato ndërkombëtare». Kisha është angazhuar për të zbatuar strategji jo të dhunshme në nxitjen e paqes në shumë vende, duke bërë të mundur që edhe autorët më të dhunshëm të përpriqen të ndërtojnë një paqe të drejtë dhe që zgjat.

Ky angazhim në dobi të viktimave të padrejtësisë dhe të dhunës nuk është një pasuri vetëm e Kishës katolike, por e shumë traditave fetare, për të cilat «dhembshuria dhe jodhuna janë thelbësore dhe tregojnë udhën e jetës». Po e përsëris me forcë: «Asnjë besim fetar nuk është

terrorist». Dhuna është një përdhosje e emrit të Hyjit. Të mos lodhemi kurrë së përsërituri: «Emri i Hyjit kurrë nuk mund ta justifikojë dhunën. Vetëm paqja është e shenjtë. Vetëm paqja është e shenjtë, jo lufta!».

### RRËNJJA SHTËPIAKE E NJË POLITIKE JO TË DHUNSHME

5. Nëse zanafilla prej nga ku buron dhuna është zemra e njerëzve, atëherë është themelore të përshkojmë shtegun e jodhunës në vend të parë brenda familjes. Është një përbërës i atij gëzimi të dashurisë, që kam paraqitur marsin e këtij viti në Nxitjen apostolike *Amoris letitia*, në përfundim të dy viteve reflektimi prej anës së Kishës mbi martesën dhe familjen. Familja është vendi ku bashkëshortët, prindërit dhe fëmijët, vëllezërit e motrat mësojnë të komunikojnë dhe të kujdesen për njëri-tjetrin pa interes, ku fërkimet apo madje edhe konfliktet duhet të tejkalohen jo me forcë, por me dialog, me respekt, me kërkimin e të mirës së tjetrit, me mëshirën e faljen. Prej brendësisë së familjes gëzimi i dashurisë përhapet në botë dhe rrezatohet në mbarë shoqërinë. Nga ana tjetër, një etikë e vëllazërisë dhe e bashkëekzistencës paqësore mes personave dhe mes popujve nuk mund të bazohet mbi logjikën e frikës, të dhunës dhe të mbylljes, por mbi përgjegjësinë, respektin dhe dialogun e sinqertë. Në këtë kuptim, po bëj një apel për çarmatimin, ndalimin dhe eliminimin e armëve bërthamore: frika bërthamore dhe kërcënimi i shkatërrimit të ndërsjellë nuk mund të jenë baza e kësaj lloj etike. Po me kaq urgjencë lus që të ndalet dhuna shtëpiake dhe abuzimet mbi gratë e fëmijët. Jubileu i Mëshirës, mbyllur në nëntor të këtij viti, ka qenë një ftesë për të shikuar brenda zemrës sonë dhe për të lënë që aty të hyjë mëshira e Hyjit. Viti jubilar na ka ndihmuar që të bëhemi të vetëdijshëm se sa të shumtë dhe të ndryshëm janë personat dhe grupet sociale, që trajtohen me indiferencë, që janë viktimat të padrejtësisë dhe që pësojnë dhunë. Ato janë pjesë e “familjes” sonë, janë vëllezërit tanë dhe motrat tona. Për këtë arsye politikën e jodhunës duhet të fillojnë mes mureve të shtëpisë, që pastaj të përhapen në krejt familjen njerëzore. «Shembulli i Shenjtes Tereza të Jezusit Fëmijë na fton në praktikimin e udhës së ngushtë të dashurisë, për të mos humbur rastin e një fjale të mirë, të një buzëqeshjeje, të çfarëdo gjesti të vogël që mbjell paqe dhe miqësi.

Një ekologi integrale përbëhet edhe prej gjesteve të thjeshta të përditshme me anë të të cilave shkatërrojmë logjikën e dhunës, të shfrytëzimit, të egoizmit».

### FTESA IME

6. Ndërtimi i paqes nëpërmjet jodhunës aktive është një element i nevojshëm dhe koherent me përpjekjet e vazhdueshme të Kishës për të kufizuar përdorimin e forcës nëpërmjet normave morale, nëpërmjet pjesëmarrjes së saj në punët e institucioneve ndërkombëtare dhe falë kontributit kompetent të shumë të krishterëve për përpunimin e legjisllacionit në të gjitha nivelet. Vetë Jezusi na jep një “manual” të strategjisë për ndërtimin e paqes në të ashtuquajturin “Fjalimi në Mal”. Tetë Lumturitë (krh. *Mt* 5,3-10) përvijojnë profilin

e personit, që mund të përcaktojmë të lumë, të mirë dhe autentik. Lumë të butët – thotë Jezusi –, të mëshirshmit, punëtorët e paqes, ata që e kanë zemrën të pastër, ata që kanë uri dhe etje për drejtësi. Ky është edhe një program dhe një sfidë për liderët politikë dhe fetarë, për përgjegjësit e institucioneve ndërkombëtare dhe për drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të mediave të mbarë botës: zbatimi i Lumturive në mënyrën me të cilën ushtrojnë përgjegjësitë e tyre. Një sfidë për të ndërtuar shoqërinë, bashkësinë apo sipërmarrjen përgjegjëse të së cilës janë me stilin e punëtorëve të paqes; të japin prova të mëshirës duke refuzuar skartimin e personave, dëmtimin e mjedisit dhe dëshirën për të fituar me çdo kusht.

Kjo kërkon gatishmërinë «për të duruar konfliktin, duke e zgjidhur dhe duke e kthyer atë në një unazë lidhëse të një procesi të ri». Të veprosh në këtë mënyrë do të thotë të zgjedhësh solidaritetin si stil për të bërë histori dhe për të ndërtuar miqësinë sociale. Jodhuna aktive është një mënyrë për të treguar, që me të vërtetë njësia është më e fuqishme dhe më pjellore, sesa konflikti. Gjithçka në botë është e lidhur ngushtë. Me siguri mund të ndodhë që diferencat të krijojnë grindje: i zgjidhshim në mënyrë ndërtuese dhe jo të dhunshme, kështu që «tensionet dhe të kundërtat të arrijnë një njësi shumëformëshe, që krijon jetë të re», duke ruajtur «potencialitetet e çmueshme të polaritetit në kontrast».

Siguroj që Kisha katolike do të shoqërojë çdo përpjekje për ta ndërtuar paqen edhe nëpërmjet jodhunës aktive dhe krijuese. Më 1 janar 2017 e sheh dritën Dikasteri i ri për Shërbimin e Zhvillimit Integral Njerëzor, që do ta ndihmojë Kishën t'i nxisë në mënyrë gjithnjë e më të efektshme «të mirat e pamatshme të drejtësisë, të paqes dhe të ruajtjes së krijimit» dhe të përkujdesjes ndaj emigrantëve, «nevojtarëve, të sëmurëve dhe të të përjashtuarve, të të mënjanuarve dhe të viktimave të konflikteve të armatosura dhe të katastrofave natyrore, të të burgosurve, të të papunëve dhe të viktimave të çfarëdo forme skllavërie dhe torture». Çdo veprim në këtë drejtim, për sa modest të jetë, ndihmon në ndërtimin e një bote të lirë prej dhunës, hapi i parë drejt drejtësisë dhe paqes.

### SI PËRFUNDIM

7. Sipas traditës, e firmos këtë Mesazh më 8 dhjetor, festën e Zojës së Papërlyer. Maria është Mbretëresha e Paqes. Kur lindi Biri i saj, engjëjt i thurnin lavdi Hyjit dhe u uronin paqe në tokë burrave dhe grave vullnetmirë (krh. *Lk* 2,14). Ia kërkojmë Virgjërës Mari që të na udhëheqë.

«Të gjithë e dëshirojmë paqen; shumë persona e ndërtojnë atë çdo ditë me gjeste të vogla, shumë vuajnë dhe e durojnë lodhjen, që sjellin përpjekjet e shumta për ta ndërtuar atë». Gjatë vitit 2017, u angazhoheshim, me lutje dhe me veprim, me qëllim që të bëhemi persona që e kanë larguar prej zemrave, fjalëve dhe gjesteve të tyre dhunën dhe me qëllim që të ndërtojmë bashkësi jo të dhunshme, që kujdesen për shtëpinë e përbashkët. «Asgjë nuk është e pamundur nëse ia kërkojmë këtë gjë Hyjit me lutje. Të gjithë mund të jemi zanatlinj të paqes».

# Domenikanët në 800-vjetorin e urdhërit dhe prania e tyre në Shqipëri

Në Romë, në kuadrin e mbylljes së kremtimeve të Jubileut të 800-vjetorit të Urdhërit të Predikatarëve (Urdhërit Domenikan), të themeluar nga shën Domeniku i Guzman-it, pranë Universitetit Papnor Angelicum u mbajt një kongres i madh i këtij urdhëri, që u nderua me pjesëmarrje edhe nga Ati Shenjt Françesku. Mes 600 pjesëmarrësve, etër domenikanë e adhurues të Shën Domenikut, ishte edhe Arqipeshkvi i Dioqezës sonë Mons. George Frendo. Për auditorin, Arqipeshkvi bëri prezente lidhjen e këtij urdhëri misionar me Shqipërinë, lidhje e cila daton që nga fillimet apo themelimi i shpallur nga Shën Domeniku. Për këtë event jubilar të Urdhërit të predikatarëve të cilit ai përket, Arqipeshkvi Mons. George Frendo na bën me dije se:

“Ky kongres mbart një domethënie të veçantë pasi është një rast për të shikuar sa besnikë kemi qenë në kohë ne domenikanët, ndaj thirrjes origjinale, d.m.th. ndaj karizmës së Shën Domenikut. Shenjti e pati vënë re se bota e ndiente nevojën e ungjillëzimit, dhe ngriti *Urdhërin e Predikatarëve* i cili është përpjekur pareshtur të ecë përpara duke mbajtur në dorë *Lajmin e Mirë*.

Është me të vërtetë e rëndësishme të theksojmë se *Urdhëri i Predikatarëve* ka qenë i pranishëm në Shqipëri vetëm pak vite pas

vdekjes së Shën Domenikut. Shën Domeniku vdiq më më 6 gusht të vitit 1221 dhe në vitin 1240, kanë ardhur në Shqipëri Domenikanët e parë. Urdhëri ka pasur shumë peshkvinj domenikanë në Shqipëri, madje një domenikan shqiptar është dërguar si Ipeshkëv në Skoci. Fakte si ky por edhe shumë të tjera flasin për një përhapje të madhe të Domenikanëve në Shqipëri. Kësisoj, domenikanët kanë pasur lidhje mjaft të afërt edhe me Skënderbeun. Rrëfyeti i Skënderbeut, pra udhëheqësi i tij shpirtëror, ka qenë domenikan dhe ndoshta edhe kjo ka qenë arsyeja që domenikanët janë dëbuar nga Shqipëria sapo otomanët arritën pushtimin e vendit. Vendi ku domenikanët kanë pasur Kuvendet apo manastirët e tyre në Shqipëri në fillim ka qenë Durrësi, por në vijim kanë pasur edhe një kuvend në Shkodër e gjithashtu edhe në jug. Me praninë domenikane në jug të vendit, lidhet emërimi im ipeshkvor: Papa Benedikti më ka më ka quajtur *Ipeshkëv Titullar i Butrintit*, për vetë faktin se në Butrint në shek. XV kanë qenë dy ipeshkvij domenikanë. Me pak fjalë domenikanët fillimisht kanë pasur aktivitet në durrës e pastaj kanë shkuar në Jug e në veri të territorit shqiptar.

Eprori i Përgjithshëm domenikan, tashmë ka hapur një *periudhë pasjubileum* duke ndjekur itinerarin sesi mund t'i kumtohet

Ungjilli atij që beson por edhe atij që nuk beson. Ky ka qenë një ndër argumentet bazë për të cilin edhe është diskutuar në Kongres. Një kusht i domosdoshëm është që ta njohim popullin, kulturën e popullit dhe historinë e popullit. Këtë e kam vënë re edhe nga përvoja ime vetiake. Sapo erdha në Shqipëri e kam ndierë nevojën që të familjarizohem me kulturën e popullit të lexoja disa vepra, madje edhe ata të Enver Hoxhës që për gjysmë shek ka sunduar popullin. Sigurisht që po ta shikonte realitetin e sotëm ai do të shtangej. Para mauzoleumit që ndërtoi për vete, sot ngrihet Katedralja e Tiranës, pra një paradoks i madh. Unë gjithnjë përsëris fjalët e shën Tomës që ka thënë se Zoti me gjithpushtetshmërinë e vet mund të nxjerrë të mirën edhe nga e keqja. Kisha katolike që ka vuajtur aq shumë në periudhën e komunizmit në Shqipëri sot është një kishë e rilindur me shumë entuziazëm.

E ne domenikanët, gjithmonë kemi pasur e kemi si mision ungjillëzimin, pasi është nevoja rrënjësore e imediate e çdo shoqërie të sotme, veçanërisht në vende si Shqipëria, që për 50-vite u indoktrinua me filozofinë e cila pretendonte se Hyji nuk ekziston dhe besimi është opiumi për popullin. Prandaj çfarë mbetet prioritar për Kishën Katolike në Shqipëri, është Ungjillëzimi”.

## Lutje e Shën Tomë Akuinit

O Hyj i gjithëpushtetshëm, që i njeh të gjitha gjërat, që nuk ke as fillim dhe as fund, që i virtyteve je dhuruesi, ruajtësi dhe shpërblyesi, denjohu që të më forcosh me themelin e qëndrueshëm të fesë, të më mbrosh me mburojën e pathyeshme të shpresës, të më zbukurosh me rrobën nusërore të Dashurisë.

Bëj që të nënshtrohem Ty nëpërmjet Drejtësisë, ti shmang kurthet djallëzore nëpërmjet maturisë, ti peshoj mirë gjërat nëpërmjet vetëpërmbytjes. Bëj që unë t'ua komunikoj pa smirë të mirën që kam atyre që nuk e kanë dhe të mos përbuz që t'ua kërkoj të tjerëve atë që mua më mungon. Bëj që unë ti pranoj me çiltërsi të madhe fajet e bëra, duke duruar me shpirt jo kryengritës dënimin e merituar.

Bëj që e mira e tjetrit të mos ngjallë në mua asnjë smirë dhe për dhuratat e tua bëj që të them gjithmonë faleminderit. Në të veshur, në të ecur, në çdo veprim bëj që të



jem gjithmonë i disiplinuar.

Bëj që ta largoj gjuhën time prej bisedave të kota, t'i pengoj këmbët e mia që të mos shkojnë këndeje e andej, ta përqendroj shikimin që dëshiron të shkapërderdhet, ti mbyll veshët ndaj zhurmave të kota, ta ul përvujtërisht fytyrën, ta lartësoj intelektin në vlerësimin e

gjërave qiellore, ti përçmoj të mirat kalimtare, të dëshiroj vetëm Ty: ta zbus mishin, ta pastroj ndërgegjën, ti nderoj shenjtërit, të të lavdëroj Ty denjësisht, të përparoj në të mirën dhe veprat e mira, që kanë një qëllim të shenjtë, ti përfundoj. Mbill, o Zot, në mua virytin, që të ndihem i tërhequr prej gjërave hyjnore, të kujdesem për detyrat e mia dhe të mos bëhem peshë për askënd në përdorimin e trupit tim. Më jep, o Zot, një pendim të zjarrtë, një kënaqje të përsosur.

Denjohu që ta rregullosh brendësinë time nëpërmjet një jete të mirë, që të bëj atë që është e hijshme, atë që më shërben mua dhe që është shembull për të afërmin.

Bëj që të mos i dëshiroj kurrë ato gjëra që bëhen për padije dhe që të ndiej neveri për gjithçka që bëhet për dembeli. Bëj që të mos lindë në mua dëshira që të filloj ndonjë veper para kohe dhe, pasi ta kem ndërmarrë atë, të mos e braktis përpara se ta çoj deri në fund. Amen.

# Françesku: bashkimi i të krishterëve është shpresë për Evropën

Në përfundim të audiencës së përgjithshme të dt. 18 janar, Papa Françesku u ndal në fillimin e Javës së lutjes për bashkimin e të krishterëve. Motoja e kësaj jave, “Dashuria e Krishtit na shtyn drejt pajtimit”, është një sfidë për ne, nënvizoi Ati Shenjt:

“T’i lutemi Zotit që të gjitha bashkësitë e krishtera, duke njohur më mirë historinë, teologjinë dhe të drejtën e tyre, të jenë gjithnjë e më të gatshme për pajtim. Na përshkoftë Shpirti i mirësisë dhe i mirëkuptimit, si edhe dëshira për bashkëpunim”.

## PAPA KUJTOI LUTJEN EKUMENIKE NË LUND TË SUEDISË

Me mallëngjim Papa Françesku kujtoi lutjen ekumenike që u bë së bashku me luteranët, në Lund të Suedisë, më 31 tetorin e kaluar, me rastin e përkujtimit të 500-vjetorit të Reformës protestante:

“Në frymën e atij përkujtimi të përbashkët të Reformës, ne shikojmë më shumë ç’na bashkon se ç’na ndan dhe vazhdojmë të ecim së bashku për ta thelluar bashkimin tonë e për t’i dhënë një formë gjithnjë e më të dukshme. Në Evropë, kjo fe e përbashkët në Krishtin është si një fill i gjelbërt shprese: i përkasim njëri-tjetrit. Bashkimi, pajtimi e uniteti janë të mundura. Si të krishterë, kemi përgjegjësinë e këtij mesazhi e duhet ta dëshmojmë me jetë. Zoti e bekoftë këtë vullnet për bashkim e i ruajtë të gjithë njerëzit, që ecin në rrugën e unitetit”.

## ATI SHENJT PËRSHËNDETI NJË DELEGACION TË ITINERARIT EVROPIAN EKUMENIK

Ati i Shenjtë përshëndeti një delegacion të Itinerarit Evropian Ekumenik dhe foli për frytet e dhjetra viteve të dialogut. “Ungjilli i Krishtit – shpjegoi – është në qendër të jetës sonë dhe i



bashkon njerëzit, që flasin gjuhë të ndryshme, banojnë në vende të ndryshme dhe e jetojnë fenë në bashkësi të ndryshme”:

“Lëvizja ekumenike, falë Zotit, po sjell fryte. Ati Qjellor vijoftë të dikojë bekimet e Tij mbi gjurmët e të gjithë bijve të vet. Motra e vëllezër të dashur, shërbejini çështjes së bashkimit e të paqes!”

## TË RINJ, TË SËMURË, TË SAPOMARTUAR LUTUNI PËR BASHKIMIN E TË KRISHTERËVE

Pastaj, Papa Françesku përshëndeti të rinjtë, të sëmurët dhe të sapomartuarit: “Të dashur të rinj, lutuni që të gjithë të krishterët të kthehen sërisht në një familje të vetme; të dashur të sëmurë, ofrojini vuajtjet tuaja për çështjen e bashkimit të Kishës; e ju, të dashura çiftë të reja, provoni dashurinë pa interes, si ajo e Zotit për njerëzimin”.

## FËMIJËT E TË RINJTË E BOSNJË-HERCEGOVINËS, MYSAFIRË NË SIÇILI

Së fundi, Ati Shenjtë tha dy fjalë edhe për dialogun ndër fetar, gjatë përshëndetjes për fëmijët e të rinjtë e Bosnjë-Hercegovinës, që, së bashku me familjet, janë mysafirë në shtëpitë e siçilianëve:

“Të dashur të rinj, duke kaluar kohën së bashku, si vëllezër e motra, në familjet ku jeni mysafirë, keni mundësi të rriteni në një klimë shprese. Vetëm kështu, ju të rinj katolikë, ortodoksë dhe myslimanë, mund ta shpëtoni shpresën për të jetuar në një botë më vëllazërore, më të drejtë e më paqësore, më të sinqertë e më të përshtatshme për njeriun. Qëndroni gjithnjë të fortë në fe e lutuni për paqen e për bashkimin në vendin tuaj e në botën mbarë. Falënderoj nga zemra familjet mikpritëse për shembullin e dashurisë dhe të solidaritetit të krishterë: jetimet duhen mbrojtur, ruajtur e pritur gjithnjë me dashuri”.

## Së bashku në të njëjtin Krisht e në të njëjtin Ungjill

Lutje Ekumenike - nga java për bashkimin e të krishterëve

Nga Ferdinand NDOCAJ

Në mjediset e Arqipeshkvisë Tiranë-Durrësit, sipas traditës së përvitshme që lidhet me “Javën e lutjes për bashkimin e të krishterëve”, përshpirtëria në Krishtin, mblodhi kokë më kokë besimtarë nga tre bashkësitë e krishtera: miqtë orthodhoksë, miqtë nga vëllazëria ungjillore si dhe mikpritësit e shtëpisë katolikët. Ky takim i përbashkët reflektimi në lutjen e pajtimit, që edhe për vendin tonë tashmë ka hyrë në vazhden e traditës, e ka nismën që nga vitin 1908 kur atë Paul Wattson, për herë





të parë propozoi 18-25 janarin, si një interval javor që përfshin festën e katedrës së shën Pjetrit dhe kthimin në fe të shën Palit. Përherë, në çdo fillimvit, për mbarë të krishterët kjo javë vjen si një tingull këmbane që bie për të na e kujtuar edhe më mirë se “është vetëm dashuria e Krishtit ajo që të shtyn me të vërtetë drejt pajtimit, larg çdo përçarje, divergjence e mosdakordësie të parëndësishme që mund të bëhet fatale”.

Mes besimtarëve nga të tre bashkësitë, ishte i pranishëm Imzot George Frendo O.P. Arqipshkëv i Arkidioqezës Metropolitane Tiranë–Durrës, Kryetari i Vëllazërisë Ungjillore Pastori Ylli Doçi si dhe disa klerikë nga bashkësia orthodhokse.

Në fillim të takimit, prezantimin dhe e hyrjen në përshpirtërinë e lutjes e bëri Atë Zef Bisha s.j., përgjegjës për zyrën e Ekumenike në Arkidioqezën Tiranë-Durrës, i cili ndër të tjera tha: “Takimi ekumenik, që na mbledh gjatë javës së lutjes për bashkimin e të krishterëve, është një moment i përvitshëm, që tashmë të gjithë ne e presim, pasi është kthyer edhe në një traditë të këndshme e mjaft domethënëse për t’u mbledhur e për ta lutur Zotin sëbashku. Edhe sot është pikërisht kjo lutje që na ka mbledhur pranë njëri-tjetrit prej bashkësive të ndryshme, sepse duam ta jetojmë Fjalën e Perëndisë, sëbashku, në këtë moment me të vërtetë vëllazëror...”.


Hyrja në lutje, rrëfimi i mëkateve dhe Mëshiro o Zot, sipas përkatësisë së të tria bashkësive u ndoq nga bashkëndarja e meditimit të mbështetur në leximet biblike.

Komenti i parë nga bashkësia mikpritëse katolike, duke reflektuar mbi Ezekielin 36, 25-27, bë prej Arqipeshkvit Imzot George Frendo, i cili vuri në dukje: “...Etërit e Shenjtë kanë parë

në këtë tekst një profeci për lindjen pagëzimore. Vetë Jezusi ka folur për pagëzimin si një rilindje dhe që është gjithmonë Hyji ai i cili na pastron për t’u bërë një krijesë e vetme; e sigurisht prandaj edhe Ezekieli me këmbëngulje flet për risinë që Zoti e krijon ndër ne: një zemër e re, një shpirt i ri. Jezusi ka thënë se ‘askush nuk e qet verën e re në rrëshiq të vjetër’, d.m.th. vera e re në rrëshiq të ri, pra angazhimi për bashkimin e të krishterëve na kërkon “një zemër të re dhe një shpirt të ri...”. Në vijim Imzot Frendo, në kontekstin e bashkimit të gjithë të krishterëve nënvizoi se: “Dekreti mbi ekumenizmin i Koncilit II-të Vatikanit, thotë: “nuk arrihet një ekumenizëm i vërtetë pa një kthim të brendshëm. Vetëm kështu do ta zbatojmë fjalën e Zotit që të jemi një grigjë e vetme me një bari të vetëm. Le të çmojmë më shumë gjërat që na bashkojnë sesa gjërat që na ndajnë. Të gjithë pranojmë të njëjtin Zot, të njëjtin Jezu Krisht, të njëjtin Shkrim të shenjtë e të njëjtin pagëzim...”.

Duke reflektuar mbi Pajtimin në Krishtin, në leximin e dytë, të shkëputur nga 2 Korintasve 5:14-20, Kryetari i Vëllazërisë Ungjillore Pastori Ylli Doçi u shpreh: “Ne takohemi si tre komunitete të krishtera që besojmë në të njëjtin Perëndi Trinor, të shfaqur në Krishtin historik që vdiq e u ringjall 2000 vjet më parë dhe që brendabanon këdo që beson në të me anë të Shpirtit të Shenjtë sot... Konteksti i fjalëve biblike të leximit, është situata e përçarë në Korint, ku disa thonin se ishin të Pjetrit dhe disa të Palit kurse disa të tjerë të Apollit (1 Kor. 3:22)... Fatkeqësisht, përçarjet nuk janë një gjë e re në familjen tonë të Krishterë por fakti që edhe sot ne jemi mbledhur përsëri të dëgjojmë Fjalën dhe Ungjillin tregon besnikëri

të admirueshme të tre komuniteteve tona ndaj Krishtit. Bota është e mbushur me armiqësi dhe ne të Krishterët e dijmë që gjithë armiqësia në Botë filloi me armiqësinë kundër Perëndisë, prandaj Pali na thotë qartë këtu me ungjillin: ‘pajtohuni me Perëndinë’ si bazën e çdo paqeje të vërtetë. Tek Romakët thuhet se megjithëse armiq të Perëndisë, mëkatarë, Krishti vdiq për ne. Kjo armiqësi është në nivel individual dhe çdo njeri ka përgjegjësi personale por kjo pamje e njerëzve si armiq të Perëndisë adresohet edhe si armiqësi në nivelin kombëtar kur thuhet tek Efesianët që Krishti pushoi në kryq armiqësinë midis të brendshme dhe të jashtëme ku nënkuptohen Hebrenjtë dhe johebrenjtë. Ashtu si në nivelin personal dhe kombëtar edhe në nivelin e përçarjeve brenda familjes së krishterë Pali tek Korintasit përsëri adreson çështjen si armiqësi me Perëndinë prandaj thekson kryqin e Krishtit. Arsyeja e kesaj zgjidhje është se gjithë armiqësitë në fund të fundit janë në rrënjën e tyre dhe në rezultatit e tyre armiqësi kundër Perëndisë. Apostulli Gjon thotë në letrën e tij të parë se “kush thotë që e don Zotin por nuk don vëllanë e tij... gënjen”. Meqenëse jeta jonë, ashtu si e Korintasve, nuk është pa përplasje dhe përçarje, ashtu si Korintasve 2000 vjet më parë Pali na thotë edhe ne: ‘pajtohuni me Perëndinë’. Në këtë kontekst nuk është për t’u çuditur që Pali u thotë besimtarëve në Romë ‘prandaj, ... jam i gatshëm t’jua shpall Ungjillin edhe juve që jeni në Romë’ (Romakëve 1:15)... Duke vënë theksin mbi pajtimin me tjetrin, pastori shtoi se: “Përgjegjësia jonë është ta japim frytin e transformimit që Pali e përshkruan edhe si ‘shërbimin e pajtimit’. Theksi këtu me të drejtë është tek pajtimi me Perëndinë por



nënkuptimi i qartë është se nuk mund të ketë armiqësi njeriu me njerinë kur është i pajtuar me Perëndinë që vdiq për të gjithë...”. “...Pali e ka shpjeguar natyrën e jetës së krishterë si një jetë ungjillore të përcaktuar nga dashuria e Krishtit për të gjithë, por ka ardhur edhe në zgjidhjen e përçarjeve dhe ndasive midis të krishterëve si disa të Pjetrit, disa të Palit e disa të Apollit duke i urdhëruar të pajtohen në Krishtin!...”. Pastori Ylli Doçi citoi më pas Artur Burns-in, me origjinë hebraike: “Burns ishte një personalitet i shquar i politikës Amerikane kur në vitet 1970 si pjesë e një studimi biblik iu dha rasti të lutej dhe tha këtë lutje: ‘Perëndi, unë lutem që t’i sjellësh Hebrenjtë të njohin Jezus Krishtin. Unë lutem që t’i sjellësh Myslymanët të njohin Jezus Krishtin. Së fundi, Perëndi, unë lutem që t’i sjellësh të Krishterët të njohin Jezus Krishtin. Amen’... Në këtë kuptim edhe unë sot lutem: Ati ynë Perëndi, bëj që Ungjillorët të njohin Jezus Krishtin. Ati ynë Perëndi bëj që Katolikët të njohin Jezus Krishtin. Ati ynë Perëndi bëj që Ortodoksët të njohin Jezus Krishtin. Amen!’ Pastori e mbylli reflektimin me fjalët: “Në Krishtin ne jemi të pajtuar!

Përfaqësuesi i bashkësisë orthodhokse nga Katedralja “Ngjallja e Krishtit” Atë Jani Meni, u përqendrua në komentimin e shembëlltyrës së djalit plangprishës, nga Ungjilli i Lk 15, 11-24: “Nga shembëlltyra, Zoti do që të na mësojë dy gjëra: E para: për çdo mëkatar ka një rrugë shpëtimi dhe kjo është rruga e pendimit; E dyta: për çdo njeri të drejtë, që të përsoset drejtësia e tij, ekziston një detyrim: dhe ky është dashuria. Biri plangprishës, që u largua nga babai dhe nga shtëpia, është çdo mëkatar që largohet nga Perëndia dhe mbulesa e dashurisë së Tij. Mjerimi në të cilin përfundoi djali plangprishës: i uritur dhe i zhveshur, në mërgim, në vend të largët; është mjerimi në të cilin e pret çdo njeri që largohet nga Perëndia dhe nga kisha...”. Më pas duke folur për kthimin e djalit të shembëlltyrës, Atë Jani shtoi: “Rruga e shpëtimit është e hapur për të gjithë, mjafton që të bëhet ai hap aq i rëndësishëm, që të na drejtojë sërish pranë Zotit, pranë Krishtit. Përfaqsimi i Perëndisë At, është atje përherë dhe pret kthimin e çdo mëkatarit. Perëndia dëshiron të shpëtojë të gjithë njerëzit”. Gjatë reflektimit mbi qëndrimin e vëllait të madh, ku nënvizohet mungesa e dashurisë vëllazërore, ai u shpreh: “Ai, gjykon më shumë ashpërsi dashurinë e pafund të babait. Këtë e bën sipas interesit dhe kritereve të tij. Mendon se dashuria e babait kundrejt vëllait të

vogël është hiperbolike. Kisha të dashur vëllazë, na përgatit dhe na jep rastin të mos biem në dëshpërimin se nuk ka shpëtim. Nga shembëlltyra e sotme, duke dashur, na përgatit që të na zgjojë nga rënia shpirtërore ku biem shpeshherë. Na zgjon nga dremitja dhe plogështia që provokon mëkati tek njeriu. Nëse duam të shijojmë frytet shpirtërore në të gjithë jetën tonë, një është rruga: pendimi i vertete dhe dashuria e sinqerte drejt Perëndisë dhe të afërmit tonë. Pendimi dhe dashuria e vërtetë, janë burimi i shpëtimit dhe bileta për në mbretërinë e përjeteshme, atje ku Perëndia pret të na shohë të gjithëve, mëkatarë dhe të drejtë”.

Takimi vazhdoi gjatë, me lutje të ndryshme, me pohimin e besimit, me lutjet e ndërmjetësimit për të kaluar tek lutja e përbashkët Ati Ynë si dhe me bekimin e shkëmbimin e paqes. Në fund ishin edhe falënderimet e të Zotit të shtëpisë Arqipeshkvit Imzot Frenzo, por edhe të përfaqësuesve të bashkësive mike, për të gjithë ata që ndihmuan që t’i jepej jetë këtij takimi. Sigurisht momente mjaft të bukura do të përjetoheshin edhe në shkëmbimin e dhuratave, por edhe më pas në bashkëndarjen e ushqimit në mjediset e Arqipeshkvisë, ku pjesëmarrësit patën mundësinë e bisedave të ngrohta e vëllazërore.

# Kisha dhe të rinjtë: Paraqitet Dokumenti përgatitor i Sinodit

Studenti Elvis Do Ceu, imzot Fabio Fabene,

kardinali Lorenzo Baldisseri, studentja Federica Ceci

Më 13 janar 2017 në Sallën e Shtypit të Vatikanit, u trajtua dokumenti dhe mori drejtim projekti që do t’i kalohet Sinodit të ardhshëm të Ipeshkvijve, në të cilin paraqitet një platformë e përmirësuar dhe e domosdoshme për aktualitetin e shoqërimit të të rinjve në rrugën e njohjes dhe të pranimit të thirrjes, si dhe për ta jetuar dhe kumtuar sa më mirë Ungjillin e Krishtit. Dokumenti në fjalë, më tepër se gjithçka tjetër, hap shtegun e komunikimit me Konferencat Ipeshkvnore, Këshillave të Hierarkive të Kishave Lindore Katolike, dikastereve të Kuries Romake dhe Bashkimit të Eprorëve të Përgjithshëm duke nxitur kështu fillimin e fazës së këshillimit me gjithë popullin e Zotit. Do të vihet në dispozicion edhe një kanal i rregullt komunikimi përmes shërbimit ON LINE, ku lirisht parashihet këshillimi e biseda e hapur me vetë të rinjtë.

Ishte Sekretari i Përgjithshëm i Sinodit të Ipeshkvijve, Kardinali Lorenzo Baldisseri, i cili hapi takimin me gazetarët e të ftuarit duke vënë në dukje se me paraqitjen e strukturës së dokumentit, kemi për qëllim të mblidhen informacione për kushtet aktuale shoqëro-kulturore të larmishme, në të cilat jetojnë të rinjtë me moshë ndërmjet 16 e 29 vjetëve, për t’i kuptuar më mirë gjatë hapave të ardhshme përgatitore të Asamblesë së Ipeshkvijve. Teksti ndahet në tri pjesë: e para është njohja e realitetit; e dyta, rëndësia e shqyrtimit; e treta



përqendrohet mbi veprimtarinë baritore të bashkësisë kishtarë. Kisha dëshiron t’i shoqërojë të rinjtë në rrugën e zbulimit dhe të realizimit të thirrjes. Kardinali Baldisseri më tej shtoi, se Termi ‘thirrje’, duhet kuptuar në të tërë gjerësinë e vet” dhe ka të bëjë me gamën e mundësive të realizimit konkret të jetës, në gëzimin e dashurisë e në përsosurinë, e cila arrihet, kur ia dhuron vetveten Zotit e njerëzve. Bëhet fjalë për të gjetur formën konkrete të këtij realizimi të plotë. Rrugët, që mund të zgjidhen në jetë,

janë të shumta. I riu mund të martohet, mund të bëhet prift, rregulltar, mund të zgjedhë një profesion, një angazhim shoqëror ose politik, pra stilin e jetës, shfrytëzimin e kohës e të parave në mënyra të tjera, nga më të ndryshmet”.

Ky dokument përgatitor i përpiluar për të qenë sa më efikas për aktualitetin që jetojmë, plotësohet nga pyetësori, i cili parashikon mbledhjen e të dhënave statistikore për çdo Kishë vendase, përgjigjet që duhet t’i jepen pyetjeve për ta njohur më mirë çdo situatë, e së fundi, të fokusojë edhe njohjen e praktikave të



ndryshme baritore, që të mund ta ndihmojnë aktualisht Kishën. Është parë mundësia, siç u tha më sipër, që të rinjtë të marrin pjesë aktivisht në këtë fazë përgatitore, përmes një kanali të internetit, në të cilin do të mund të shprehin mendimet, dëshirat dhe shpresat e jetës së tyre.

Në vijim të veprimtarisë ka qenë Imzot Fabio Fabene, zëvendës-sekretari i Sinodit të Ipeshkvijve, që shpjegoi gjithashtu arsyen e zgjedhjes së kësaj rruge: "Sinodi i ardhshëm nuk dëshiron t'i japë përgjigje vetëm pyetjes

sesi mund të shoqërohen të rinjtë në përpjekjen për të zgjedhur rrugën më të përshtatshme të jetës, në dritën e Ungjillit, por edhe t'i dëgjojë dëshirat e tyre, t'i njohë planet, ëndrrat, që kanë për ardhmërinë e tyre. Duhet gjithmonë pra, një vëmendje e posaçme, për t'i njohur nga afër edhe vështirësitë e shumta që ndeshen në realizimin e planeve në shërbim të shoqërisë, ku të rinjtë dëshirojnë të jenë protagonistë veprimtarë".

Në këtë platformë pune, për t'i vënë në lëvizje të gjithë hallkat e nevojshme që t'i shërbejnë sa më

mirë të rinjve, veç të tjerave do të ndërmerren edhe një mori nismash, duke nisur nga mbrëmësore lutjesh, takime ndërkombëtare, koncerte...

E përgjigjet, që do t'i jepen pyetësorit të Dokumentit përgatitor si dhe ato të të rinjve, do të shërbejnë si bazë për hartimin e Dokumentit të punës apo të Instrumentum laboris, që do të jetë pikëmbështetja për diskutimet e Etërve sinodalë. E rëndësishme u konsiderua edhe fjala e dy të rinjve të famullisë romake të Shën Tomës Moro.

# Çka është e drejtë dhe e gabuar në fejesë?

Nuk fejojesh thjesht me një trup,  
por me një person që ka trup dhe shpirt

Nga Dom Marjan LUMÇI

Në Ditën Botnore të Rinisë në Paris, një djalë e pati pyet Shën Gjon Palin II: "Çka është e drejtë dhe e gabuar në fejesë?"

Kësaj pyetje, Papa i'u përgjigj duke thënë: "Është e mirë gjithçka që ti mund ta bësh pa ndrojtje në sytë e nënës tënde!" Nëse Krishti të kërkon të jesh i pastër në fejesë, thuaj po. Ne nuk jemi askushi për ti dhanë mësim lumturie, Krijuesit të lumturisë.

Fejesa është një kohë e çmuar për të zbuluar se kush dhe si do të jetë shoku yt i jetës si dhe nëna apo babai i fëmijëve të tuaj. Kush dashuron vetëm për sot dhe nuk ka një interes dashurie edhe për nesër, ai apo ajo nuk e din se çfarë është dashuria, por thjesht ndjek kapriçot e çastit dhe nuk shijon si duhet asgjë. Dashuria e vërtetë zgjat përgjithmonë. Edhe pse pastaj, sigurisht çdo bashkëjetesë, me kalimin e kohës sigurisht ka vështirësitë dhe problemet e saja.

## NUK JE FEJUAR ME NJË TRUP, POR ME NJË PERSON

Asnjë person nuk është thjesht objekt kënaqësie për të kënaqur epsheet egoiste dhe të çrregullta që shpesh e banojnë personin njerëzor. Partneri i yt nuk është thjesht një objekt për tu shfrytëzuar. Nëse ti dhe partneri i jot e përdorni njëri-tjetrin vetëm për ti dhënë njëri - tjetrit kënaqësi fizike, ju thjesht po jetoni një "bashkim egoizmas" dhe asgjë më tepër, duke e zvogëluar vetveten tuaj, sepse dashuria e vërtetë nuk kërkon në tjetrin diçka që atë thjesht ta kënaqi, por dikë për ta bërë të lumtur. Ti nuk je fejuar me një trup, por një person që ka trup edhe shpirt. Lumturia e partnerit tënd duhet të jetë edhe lumturia e jote.

## MUNGESA E BESNIKËRISË, ËSHTË KANCERI I DASHURISË

Ji besnik me partnerin tënd, nëse do që dhe partneri të jetë besnik me ty. Mungesa e besnikërisë, është kanceri i dashurisë. Kërko një partner i cili me të vërtetë ka përmbajtje në atë që thotë kur flet e në mënyrën se si vishet. Kush flet pa u matur, ose dhe kush vishet në



mënyrë çrregullt, dëshiron që të vlerësohet për atë që shfaq përjashta, don të vlerësohet për atë trupi i tij ose i saj ofron. Karakteristikat e tuaja fizike nuk janë dhe nuk duhet të jenë dinjiteti yt. Ti vlen më shumë se pamja e jashtme, ti kë një shpirt që Ati e ka vendosur brenda teje, por që ti duhet ta bësh të reflektosh në jetën tënde të përditshme.

## KOHA E FEJESËS ËSHTË SHKOLLË DASHURIE

Fatkeqësisht për traditën tonë popullore shqiptare, fejesë do të thotë automatikisht martesë. Në të vërtetë nuk do të duhej të ishte kështu. Koha e fejesës duhet të jetë një kohë në të cilën partnerët jetojnë në mënyrë intensive njohjen reciproke të karaktereve të tyre. Pra fejesa është një kohë në të cilën ti mëson se si do të duhej me dashtë mandej gjatë gjithë jetës në martesë, prandaj edhe quhet si kohë parapërgatitore për martesën. Shkollë dashurie, kështu mendoj se do të duhej të quhej më mirë periudha e fejesës.

Por sa duhet të zgjasë kjo shkollë? Janë të shumta fatkeqësisht rastet kur partnerët bashkohen në martesë pas më pak se tre muajsh

fejesë. Gjë kjo aspak normale dhe shpesh herë shumë e dëmshme për jetën e nesërme të çiftit. Përgjithësisht këshillohet një periudhë e cila shkon nga një vit e gjysmë e deri në dy vite fejesë, pikërisht për tu dhënë mundësi partnerëve që të krijojnë një ide më të qartë mbi atë se çfarë e pret në vitet e mëpasme të martesës. Sigurisht se gjatë kësaj kohe ti nuk mund dhe nuk duhet të njohësh plotësisht partnerin, por do të kesh ide më të qarta mbi karakterin e personit që do të jetë shoqëruesi yt për të gjithë jetën. Është pikërisht fejesa në të cilën hapen sytë, sy të cilët më pas disi mbyllen në martesë.

## SUKSES I SIGURT NËSE ECIM DUKE U MBËSHTETUR NË TRI SHTYLLA

Zot-Dialog-Kujdes ndaj gjërave të vogla.

Për me ba që dashuria gjatë fejesës dhe martesës të jetë e frytshme dhe e në rrugën e duhur duhet patjetër që të kihen parasysh këto tre gjëra që sapo i përmenda.

Zoti: Një çift i cili lutet së bashku, mbetet gjithmonë i bashkuar. Nuk është i mjaftueshëm thjesht shikimi sy më sy, karakteristikë themelore e ditëve të para të njohjes, por është më pas i

domosdoshëm shikimi në një pikë të vetme, domethënë drejt Krishtit. Është Ai garantuesi i suksesit në martesë dhe në jetën bashkëshortore.

Dialogu: Nëse në mes të çiftit, pavarësisht probleme që dalin, është gjithmonë e nderur dhe e mirëpritur kultura e dialogut, atëherë do të kemi më shumë harmoni shpirtërore e cila do të reflektohet automatikisht në harmoninë martesore. Duke dialoguar, çifti arrin të kapërcejë pengesat karakteriale që mund të ekzistojnë mes tyre. Nëpërmjet dialogut zbulohet bindja që secili ka mbi rrolin që besimi luan në jetën e çiftit; Nëpërmjet dialogut zbulohet aftësia që secili prej partnerëve ka për t'ju hapur jetës dhe pikëpamja që ata kanë mbi mënyrën se duhet të edukohen fëmijët e tyre të ardhshëm; Nëpërmjet dialogut zbulohet

dhe shfaqet qartazi nëse dashuria mes tyre është e formuar apo ka ende rrugë për të bërë; Nëpërmjet dialogut çifti arrin të zbulojë nëse interesat e tyre janë të përbashkëta dhe përputhen mirë, apo pikërisht këto interesa me pas janë mollë shërri për ecjen e tyre përpara në mënyrë harmonike! Pra, duhet dialog, për të kuptuar edhe për të arritur në një njohje të vërtetë.

Kujdesi ndaj gjërave të vogla: Arrihet tani në një pikë e cila kam frikë se shpesh herë lihet disi mbas doret. Edhe pse e dijme mirë se shtëpia nuk ndërtohet mur sipër muri, por gurë sipër guri (fatkeqësisht shtëpitë prefabrikate ndërtohen murë pas muri, dhe siç e dijme nuk jetojnë gjatë), atëherë ekziston edhe tendenca për të menduar dhe besuar se dashuria kërkon heroizma dhe nëse nuk je i zoti apo e zonja ti bësh, atëherë ti

nuk vlen. Mendim krejtësisht i gabuar. Dashuria e vërtetë në çift, për tu mbajtur e gjallë dhe e fortë nuk kërkon gjëra të mëdha, por kujdes të vazhdueshëm ndaj detajeve të vogla, ndaj atyre detajeve që duken si të pa vlera, por që në të vërtetë janë shkëndija që e mban gjallë dashurinë. Nënë Tereza nuk u kërkonte gjëra të mëdha motrave të saja, por gjëra të vogla me dashuri të madhe.

Dashuria në fejesë e më pas në martesë nuk mund të jetë jo-aktive. Për këtë arsye shpesh herë janë kujtimet e së shkuarës dhe kujdeset për gjërat e vogla të së ardhmes që e ushqejnë dashurinë. Çdo kujtim sjell gëzim, por ama çdo kujdes ndaj detajeve e shton dhe e shumëfishon dashurinë, sepse dashuria është një zjarr i cili duhet të ushqehet për të mbetë gjithmonë i nderur.

## Bukuria e shpirtit

Dy të rinj të dashuruar vendosën të martohen. Disa muaj para martesës, vajza pëson një aksident dhe mbetet me fytyrë të shpërfytyruar.

- Nuk mund të martohem me ty - i thotë të fejuarit "unë do të mbetem gjithnjë e shëmtuar. Gjej ndonjë vajzë tjetër të bukur ashtu siç e meriton, sepse unë nuk vlej më për ty". Pak ditë më vonë, ajo merr këtë përgjigje nga djali: "Ai që duhet me të vërtetë të ndihet keq, jam unë. Pas një vizite tek mjeku, ai më tha që së shpejti unë nuk do shoh më. Por me gjithë, këtë nëse ti do akoma të martohesh me mua, unë jam gati"

Pas pak kohësh ata u martuan dhe djali "i iku shikimi". Pavarësisht kësaj jetuan 20 vjet së bashku në dashuri dhe mirëkuptim. Vajza ishte ajo që kujdesej dhe u bë drita e syve të tij. Një ditë ajo u sëmur keq dhe vdiq, duke lënë pas një keqardhje të madhe që po e linte në atë gjendje.



Atë ditë për çudinë e të gjithëve ai hapi sytë.

- Unë nuk isha i verbër tha. Por bëra si i tillë që ajo mos të ndihej keq që po e shihja përditë

me fytyrë të shpërfytyruar, sepse dashuria ime për të ishte e bazuar në bukurinë që ajo kishte në shpirt.

## Dele të humbura, apo ujë grabitqarë?

### Dëshmitarët e Jehovahit?!!!

Nga Dom Marjan LUMÇI

Pothuajse çdo njeri është ndeshur me agresivitetin ose bezdisjen e vizitave të tyre në çdo derë në çdo orë të ditës, për të kthyer njerëzit në besimin e tyre. Organizata që ata përfaqësojnë, e njohur si Bibla e Kullës së Rojës dhe Shoqëria e Pamfleteve (BKR & SHP) e vënë theksin tek profecitë e kohëve të fundit dhe kanë parashikuar fundin e botës, por pa sukses. BKR&SHP ushtron kontroll të rreptë mbi Dëshmitarët e Jehovahit dhe ndalon pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të tilla të zakonshme si transfuzion gjakut, marrjen e gjakut në raste nevojë, festim ditëlindjesh ose festash (duke përfshirë Krishtlindjet, Pashkët, Ditën e Nënës)

pjesëmarrjen në votime, betimin përpara flamurit dhe shërbimin ushtarak. Ndalojnë e martesën jashtë fesë së tyre, etj. Nëpërmjet këtyre kufizimeve, BKR&SHP ngre një mur izolimi midis Dëshmitarëve të Jehovahit dhe pjesës tjetër të shoqërisë.

#### E KALUARA HISTORIKE

Bibla e Kullës së Rojës dhe Shoqata e Pamfleteve pretendojnë se është e vetmja organizatë që Hyji po përdor sot, që të shpjegojë të vërtetën dhe të flasë për Të.

Sipas BKR&SHP, të gjithë ata që nuk janë Dëshmitarë të Jehovahit do të shkatërrohen në Armagedon, një ngjarje e gjykimit hyjnor,

që ata thonë se është shumë e afërt.

Shoqëria Kulla e Rojës shtyp çdo javë mbi 15 milionë kopje të revistave të saj në 120 gjuhë dhe ka mbi 5 milionë Dëshmitarë të Jehovahit [botues] që përhapin doktrinën në 230 vende. Më poshtë do të jenë disa fakte të historisë dhe besimeve të Dëshmitarëve të Jehovahit, të cilat çdo njeri duhet ti dije.

#### DOKTRINA DHE BESIME TË HUAZUARA

Carls T. Rasell (1852-1916) themeloi lëvizjen e Dëshmitarëve të Jehovahit. Kur ishte një adoleshent ai mohoi rrënjët e tij

Presbiteriane, u bashkua me një bashkësi më liberale dhe më vonë u largua edhe prej saj.

Ai mohoi hyjninë e Jezu Krishtit dhe mësimet biblike për ferrin dhe dënimin e përjetshëm. Rasell nuk kishte shkollim biblik, por e huazoi dhe ndërtoi besimin nga mësimet e ndryshme, të cilat ishin të njohura në atë kohë. Për shembull, adventizmi influencoi tek ai mohimin e *ferrit*; një fraksion adventist i udhëhequr nga N.H.Barbur ngjalli interesin e tij për profetët e kohëve të fundit. Nga Barbur ai huazoi besimin se Krishti u kthye në mënyrë të *padukshme* në botë në vitin 1874, dhe se viti 1914 ishte viti i shkatërrimit të botës dhe fillimi i mijëvjeçarit të Ri.

### PRETENDIME FANTASTIKE

Në vitin 1879 Rasell nxori revistën e tij të parë *Kulla e Rojës e Sionit* dhe *Heraldi i Prezencës së Krishtit* (sot e njohur si *Kulla e Rojës*) për të reklamuar doktrinat e tij. Njerëzit u tërhoqën nga predikimet sensacionale të Rasell për kohët e fundit dhe kështu organizata u zgjerua.

Pavarësisht nga mungesa e shkollimit të tij në teologji apo në gjuhët biblike, Rasell pretendoi se ishte i vetmi që dinte të vërtetën dhe fuqishëm dënoi besimet e tjera të krishtera. Si rrjedhojë, përfaqësuesit e besimeve të ndryshme filluan të ekspozojnë mësimet e pavërteta të Rasell dhe karakterin e tij të dyshimtë.

### KARAKTER ME TË META

J.J.Ras publikoi një pamflet ku ekspozoheshin pretendimet dhe doktrinat e rreme të Rasell. Ai zbuloi se Rasell "kurrë nuk kishte ndjekur shkollën e lartë; nuk di gati asgjë nga filozofia, teologjia historike ose sistematike dhe është krejtësisht i paditur në gjuhët biblike (hebraisht dhe greqisht). Pa arritur sukses Rasell u mundua të ndalonte qarkullimin e këtyre informacioneve shkatërruese për të, duke e hedhur në gjyq Rev. Ras me akuzën për shpifje. Megjithatë, Rasell jo vetëm që e humbi gjyqin, por në procesin gjyqësor bëri dëshmi të rreme kur gënjeu nën betim, se gjoja kishte njohuri të gjuhës Greke. Në fund Rasell pranoi se gjithçka e thënë rreth tij në pamflet ishte e vërtetë.

Më 1913, Rasell, pa pasur sukses hodhi në gjyq "*Shqiponja*" e *përditshme e Bruklinit* për shpifje, kur kjo gazetë botoi përpjekjet e tij mashtruese për të shitur grurë të zakonshëm me çmimin e lartë 60 dollarë për kilogram, duke pretenduar se ishte "Grurë i mrekullisë".

### PROFECI TË DËSHTUARA

Me gjithë këto të meta, Raselli vazhdoi të tërhiqte njerëz me interpretimet e tij fantastike dhe profetike dhe paralajmërimet e tij dramatike se Armagedoni do të ndodhte në vitin 1914.

Kur viti 1914 erdhi dhe shkoi, ai e ndryshoi kohën për në vitin 1915. Raselli vdiq në 1916 duke i lënë dishepujt e tij në dyshimin dhe zhgënjimin e parashikimeve të tij të dështuara. Jozef Franklin Radherford e mori atëherë organizatën nën kontroll.

### PROFECI PËR PERFITIME

Radherford (1869-1942) gjithashtu përdori dhe kërcënoi me Armagedonin për të frikësuar Dëshmitarët e Jehovait. Ai botoi "*Misteri i mbaruar*" një libër i cili parashikonte se vitin 1918 Perëndia do të shkatërronte kishat dhe miliona anëtarë të tyre dhe lajmëroi se në 1920 çdo mbretëri do të përfihej nga anarkia.

Radherfordi shpjegonte se e vetmja rrugë për të shpëtuar nga gjykimi i afërt dhe shkatërrimi, ishte bashkimi me organizatën Kulla e Rojës.

Frika nga Armagedoni i nxiti Dëshmitarët për të punuar më shumë për shitjen e librave të Radherford dhe literaturës tjetër të Kullës së Rojës. Kur parashikimet për vitin 1918 dhe 1920 dështuan, Radherfordi caktoi një datë të re në librin e tij të titulluar "*Miliona që tani jetojnë nuk do të vdesin kurrë*" (1920). Ky libër mëson se mijëvjeçari do të fillonte në vitin 1925 dhe se Shenjtoret e Dhjatës së Vjetër si Abrahami, Isaku, Jakobi dhe Davidi do të vijnë përsëri në jetë. Kulla e Rojës ndërtoi edhe një vilë luksoze spanjolle, të quajtur Beth-Sarim (Shtëpia e Princërve), gjoja për të strehuar këta patriarkë. Ndërkohë Radherfordi u rehatua në vile. Ai, gjithashtu, në kohën e Krizës kishte një veturë të re shumë të shtrenjtë, ndërkohë që anëtarët e thjeshtë të Dëshmitarëve të Jehovait shisnin derë më derë librat dhe pamfletet e Kullës së Rojës dhe punonin në qendrën drejtuese të Bethel për 10-15 dollarë në muaj. Gjashtë vjet pas vdekjes së Radherford, në vitin 1942, shenjtoret e Dhjatës së Vjetër ende nuk erdhën, kështu që shoqëria pa *zhurmë* shiti vilën "Beth-Sarim", duke mbyllur kështu një kapitull të turpshëm në historinë e tyre të parashikimeve.

### FALSIFIKIMI I BIBLES

Nën drejtimin e Nethen H. Norr (1905-1977), Shoqëria Kulla e Rojës e la mënjanë

caktimin e një date për një farë kohe dhe zgjodhi një strategji tjetër. Meqenëse shumë nga mësimet e tyre hidhen lehtësisht poshtë nga vargje të rëndësishme të Biblës së Mbretit Jakob (King James Bible), Norr vendosi të botojë një Bibël tjetër vetëm për Dëshmitarët e Jehovait. Bibla e Kullës së Rojës, e quajtur Përkthimi i Botës së Re (*New World Translation*), zhurmshëm ndryshuan shumë vargje të cilat tregojnë gabimet e mësimave të Kullës së Rojës. Shembulli i thjeshtë dhe me i miri ishte nga Ungjilli i Gjonit 1,1, i cili në King James Version, qartësisht deklaroi hyjninë e Jezusit - "Fjala ishte Hyj". Shoqëria Kulla e Rojës e mohon hyjninë e Jezu Krishtit, kështu New World Translation e *shndërroi* fjalinë në "Fjala ishte një Perëndi."

Një shembull tjetër gjendet në Dhiatën e Vjetër, në librin e Zakarisë, kapitulli 12,10. Perëndia Jehova flet dhe thotë, "ata do të vështrojnë drejt **meje**, drejt atij që kanë shporuar, e kuptuar nga të krishterët si një referencë e qartë parashikuese për kryqëzimin. Duke njohur se përmbushja e kësaj profecie të Jezusit do të thotë se ai është Hyji Jehova, Shoqëria Kulla e Rojës e ka ndryshuar këtë varg në *New World Translation* në "ata sigurisht do të shohin tek Ai të cilin e kanë therur," duke eliminuar kështu një fakt tjetër të hyjnisë së Jezu Krishtit. Shoqëria bëri ndryshime të ngjashme në shumë vargje të tjera të lidhura me hyjninë e Krishtit (Kolozianëve I: 16-20, Titi 2,13, Hebrejve 1,8). Ata gjithashtu kanë ndryshuar vargje që shfaqin falsitetin e mësimave të Shoqërisë Kulla e Rojës, në subjekte të tilla si realiteti i dënimit të përjetshëm (Mateu 25,46), dhe personaliteti i Frymës të Shenjtë (1 Korintasve 14.14-16, 1 Timoteu 4,1, Juda 19). Në këtë mënyrë Shoqëria Kulla e Rojës i jep Dëshmitarëve të Jehovait dhe të konvertuarve të mundshëm iluzionin se Bibla mbështet doktrinat e saj të gabuara.

Grupi për përkthimin e *New World Translation* u mbajt anonim, pa dyshim për të mbuluar mungesën e tyre të kualifikimit teologjik. Asnjë nga njerëzit që punoi në këtë projekt nuk kishte kualifikim në gjuhët biblike, me përjashtim të Frederik Franc. Ai ishte kryetari i grupit dhe kishte studiuar greqisht për dy vjet në Universitetin e Sinsinatit, pa arritur të diplomohet, dhe kështu mësoi vet hebraishten.

Pas vdekjes së Norr, Franc u bë presidenti i ri i Shoqërisë Kulla e Rojës.

# “Donin ta kapnin, por askush nuk guxoi të vinte dorë mbi të” (Gjoni 7, 25-30)

*I dashur, ku u fshehe,  
duke më lënë në dënese?  
Ike si një kaproll,  
dhe mua më plagose;  
Edhe kur të ndjek,  
edhe kur dal e të thërras:  
Ah, më kot të kërkoj!*

“Ku je fshehur?” Është njëloj sikur shpirti të thoshte: “Një fjalë të vetme dhëndri im; tregoma strehëzën ku Ti rri”. Kjo tregon, që shpirti i lutet Atij, që t’ia tregojë ekzistencën e Tij Hyjnore; sepse vendi, ku Biri i Hyjit prehet”, kështu na thotë Shën Gjoni, “është zemra e Atit” (shih. Gjoni 1, 18); apo thënë ndryshe, ekzistenca Hyjnore është e padukshme për çdo shikim të vdekshëm, e pakuptueshme për çdo arsye njerëzore. Isaia i drejtohet Zotit duke thënë: „Vërtet, Ti je

një Zot i fshehur“ (Isaia 45, 15). Pra, le të kemi parasysh: sado e madhe të jetë përvoja shpirtërore, sado e lartë të jetë dija, të cilën Zoti ia dhuron shpirtit në këtë jetë – gjithçka që ky shpirt percepton nuk është thelbi i vërtetë hyjnor dhe s’ka të krahasuar me të. Në realitet, Zoti i fshihet gjithmonë shpirtit tonë. Sa herë që shpirtit i zbulohen mrekulli, ai duhet ta konsiderojë Hyjin përsëri si të fshehur, duke e kërkuar në fshehtësinë e Tij e duke i thirrur: „Ku je fshehur?“. Dhe vërtet, as përvoja e madhe shpirtërore dhe as ndjesia e thellë e pranisë së Zotit, nuk janë ende një dëshmi absolute e pranisë mirëdashëse të Tij në shpirtin tonë; gjithashtu, edhe mungesa e hireve të tilla apo thatësia shpirtërore, nuk janë kurrsesi dëshmi e mungesës së Tij. Dhe kjo është pikërisht ajo, që na shpall Profeti Job: „Vjen tek unë e nuk e shoh; më bie përbri e

s’e hetoj“ (shih. Jobi 9, 11). Nga kjo duhet të kuptojmë se, edhe sikur një shpirt të mbushet me aftësi, njohje dhe përvoja frymore, ai nuk mund të jetë aspak i sigurt, se e zotëron Zotin apo e sheh qartë dhe qenësisht Atë; apo të mendojë, nisur nga hiret e mara, se e zotëron Zotin më shumë apo ka depërtuar më thellë në Të. Po ashtu, shpirti, nëse i mungojnë të gjitha këto aftësi të kuptuari dhe përvoja shpirtërore, duke u ndjerë në errësirë, i braktisur dhe në nevojë, nuk duhet të mendojë kurrsesi se e ka më pak me vete Zotin... Qëllimi i vargut të poemës nuk është, që shpirti të përgjërohet për përshtirëri afektive dhe shqisore, të cilat nuk ta japin as qartësinë dhe as sigurinë e pasjes së dhëndrit në këtë jetë. Por, shpirti lutet për praninë dhe kundrimin haptazi të Qenies së Zotit, i cili dëshiron ta ketë shpirtin përfundimisht në jetën tjetër.

## Adriano Celentano vs Dario Fo

Dario Fo i cili ishte dramaturg, aktor, regjizor, shkrimtar, piktur dhe skenograf. Vdiq me 13 tetor 2016.

Adriano Celentano, në ditën e vdekjes së mikut të tij të vetëshpallur ateist i bën këtë dedikim si bisedë miqësore.

**H**ej, Dario... Dario! Mos bëj sikur nuk dëgjon... e di që më dëgjon... edhe më sheh... Vazhdon të ecësh duke më kthyer kurrizin sepse nuk do të të dalloj... dhe nuk do të pranosh që kisha të drejtë... Ti mund të kesh qenë një Çmim Nobel dhe këtu në tokë ke bërë gjëra madhështore. Ke revolucionarizuar kulturën e mënyrës së të qenurit dhe i ke kthyer dinjitetin të shtypurve. Gjëra të mëdha sigurisht; në tokë, më shumë nga ç’ke bërë, s’mund të bëje. Por nga qielli? Nga qielli jo, nga qielli s’kuptove kurrë asgjë.

Dhe zbaviteshe duke u rreshtuar mes atyre që nuk besojnë. Po si mund të jesh kaq I MADH sa ke qenë ti, dhe njëherësh edhe kaq injorant? Kjo gjë më tërbon! Një mangësi kjo që mund të përmbyste të gjithë komisionin e Nobelit. Por ata, ata që të vlerësuan, nuk janë budallenj. Atë Nobel ta dhanë për meritë. Nuk ia vunë veshin atyre që ti brohorisje gabimisht. Mbase e bëje me qëllim, për të kënaqur "të majtën" tënde të dashur, që sot për të thënë të drejtën është pak e copëtuar, dhe për t’i dalë kundër kishës, që skandale, dhe këtu jam dakort me ty, ka grumbulluar jo pak.

Ka filmime që të shfaqin gjatë ceremonisë, kishe veshur frak, por gjëja më verbuese ishte shprehia jote. Një shprehje nëpërmjet së cilës nuk mund të mos lexohej ajo që je përbrenda. Është



shpirti yt ajo çka vlerësuan. Ja përse, nga aty lart, ATI, sa herë që ti vetëshpallësh ateist, shkrihej së qeshuri deri në atë pike sa shkaktonte stuhi në të gjithë tokën. Ti ke besuar përherë i dashur Dario, vetëm se nuk e dije. Ose, e kuptoje, por nuk doje ta pranoje. Siç po bën tani. Vazhdon të ecësh dhe nuk e kthen kokën, që të mos më thuash "po Adriano, paske pasur të drejtë ti, Parajsa ekziston vërtet!". Por nuk e thua. Drita

shtohet, por ti nuk e kthen kokën dhe në çdo hap që hedh, një copë e trupit tënd të vjetëruar shkëputet nga qielli për të rënë në tokën që i plak njerëzit.

Do ishte interesante, do thosha spektakolare, nëse përballë provës se pamohueshme të rinisë tënde të rigjetur dhe të përjetshme, të kishe forcë t’i thoshe përsëri Atit që je ateist. Ti do ishe në gjendje ta bëje...